[Shqiptarja.com]

E premtë 6 Mars 2026 - Përditësimi i fundit 21:10

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DRIT/PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOLIE FOTOGALERI VIDEOGALERI PRË E ZOZË SONDAZHE

POP 5 Shiko REKORDIN E FUTBOLLIT KOMP

1 Shefoni Kaçi 3 vite shërbimin pas burgut si sekretarëse ligjore ishte i dënuar me vjedhje

2 Investigimi i Shqiptarjës: Legjenda e futbollit Ismail Kadaré shumë në problemet e shëndetit

3 Nga i Vlorës ca le ke gënjeshtra i dënon Gjykata Administrative, Ministrit Veliaj i ngel vendi pa punë

4 Kamadeli gjumar ndërtoi shtëpi me kamarierët shqiptar me 'shpërblim' 5 mijë euro

5 Ishulloja e Sarës, mbyten dy djem i mitrofanëve

Kronikë

'Lufte' vëllezërish për një 'copë tokë' në Lushnjë, vdes 70-vjeçari që u qëllua me plumb në kokë! Tjetri i plagosur me sëpatë, në spital

Një krim i rëndë në familje u shënua në Çukas të Lushnjës, ku dy vëllezër u konfliktuan për një sipërfaqe toke. 77-vjeçari Nazif Musai vrau vëllanë me pistoleti, ndërsa vëllë mbeti i plagosur gjatë përleshjes me sëpatën.

- Vëllezërit rrihen me njëri-tjetrin për pronën edhe në Mat
- Shefi i Komisariatit të Lushnjës sqaron ngjarjen e rëndë mes vëllezërve: Konflikti për motive pronësie agravoi

Redakcia
6 Mars, 18:10 | Përditësuar: 6 Mars, 14:58

Share

Në fshatin Çukës të Lushnjës, dy vëllezër u përfshinë në konflikt për çështje pronësie, ku njëri mbeti i vdekur e tjetri i plagosur. Shkak për shenin që nisi me sëpatën e përfundoi tek pistoleta është bërë një sipërfaqe e vogël toke, e cila ndodhet mes dy shtëpive të vëllezërve Musai.

Burimet bëjnë të ditur se vëllezërit nuk kishin gjetur dakordësinë për ta përdorur kënë tokë si rrugë për të futur makinat në oborret e shtëpive. Fillimisht Haziz Musai 70-vjeç ka goditur me sëpatë të vëllanë, Nazifin 77-vjeç, duke i shkaktuar plagë në trup. Më pas 77-vjeçari ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar në kokë vëllanë. 70-vjeçari Haziz Musai u dërgua menjëherë në spitalin e Traumës, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve.

Shefi i komisariatit të Lushnjes, Edmond Pjetraj dha detaje nga vendngjarja.

LEXO EDHE:
Hetimi ndaj Sali Berishës, Meta: Sulm politik i urdhëruar nga Rama, ia treguam më 20 shkurt kush jemi

> *"Dy vëllezër pas një konflikti për motive pronësie, fillimisht me sende të forta, konflikti ka agravuar në përdorimin e armëve të zjarrit. Policia ka marrë masat, është sekuestruar arma, është kapur autori dhe po kryhen të gjitha veprimet hetimore." tha Edmond Pjetraj, drejtuesi i komisariatit të Lushnjës.*

I plagosur mbeti 77-vjeçari, i cili po merr mjekim në spitalin e Lushnjës. Ndë dëshmitë e parë për hetuesit, Nazif Musai deklaroi se vëllai i vogël e ka goditur disa herë, duke e vënë poshtë, kështu u detyrua të detyrua të rixirte armën. I moshuari tha se debatet për tokën kanë qenë të vazhdueshme mes tyre.

Rendit dhvilimet sipas orarit: TË FUNDIT

Ora 12:32

Konflikti i pronësisë në Lushnje/ 70-vjeçari ndërron jetë tek Trauma pas plumbit në kokë që mori nga i vëllai

Ndërron jetë i moshuari Haziz Musai, i cili u qëllua me pistoletë nga vëllai i tij Nazif Musai sot në Lushnjë. Lajmin e bën me dje gazetari i Report Tv Freard Rista. I ndjeri kishte marrë plumb në kokë dhe nuk ka mundur të mbijetojë.

Duke qenë se ende nuk kanë ardhur familjarët, procedura e kërkon të mbahet dy orë në spitalin e Traumës në pritje të familjarëve e më pas do të dërgohet në morg.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:48

Konflikti për motive pronësie në Lushnje/ Vëllai i plagosur niset drejt Traumës

Haziz Musai i plagosuri me armë zjarri nga vëllai i tij Nazif Musai mëngjesin e sotëm në Çukas të Yletërë, niset për në spitalin e Traumës. Gjendja e tij është kritike për jetën.

Nazifi 77-vjeçar po i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale ne spitalin e Lushnjes, pasi ka plagë në krah e këmbë nga sëpata dhe kosorja me të cilën u qëllua nga Hazizi.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:40

Vëllezërit rrihen për pronën edhe në Mat, 61 vjeçari godet me sende të forta në fytyrë të vëllanë

Foto ilustruese

Mat- Një ipetër sherr mes vëllezërsh është shënuar sot pas atij të mëngjesit të ndodhur në Lushnje.

I njëjti motiv: Prona. Këtë herë në fshatin Midhë të Matit.

Ndërhyrja e policisë parandaloi përshkallëzimin e konflikëit duke arrestuar në flagrancë shtetasin Sl.S., 61 vjeç, banues në fshatin Midhë, Mat.

Ky shtetas, për motive të pronësisë, ishte konfliktuar dhe kishte goditur me sende të forta vëllanë e tij, duke i shkaktuar dëmtime në fytyrë.

Dosja i kalon Prokurorisë së Dibrës.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:23

Shefi i Komisariatit të Lushnjes sqaron ngjarjen e rëndë mes vëllezërve: Konflikti për motive pronësie agravoi

Komisari drejtues i Komisariatit të Lushnjes, Edmond Pjetraj ka zbardhur ngjarjen e konfliktit të dy vëllezërve në Çukas të Yletër. Konflikti për motive pronësie ka agravuar deri në përdorimin e armës.

> *"Dy vëllezër pas një konflikti për motive pronësie. Fillimisht me sende të forta, konflikti ka agravuar me përdorimin e armëve së zjarrit, ku njëri prej vëllezërve N.M., 78 vjeç ka goditur me armë zjarri vëllain e tij 70 vjeç, i cili ndodhet në spitalin e Lushnjes. Policia ka marrë të gjitha masat. Është sekuestruar arma e zjarrit. Janë sekuestruar të gjitha provat materiale. Autori është kapur dhe po kryhen të gjitha veprimet e tjera hetimore në vazhdimësi. Ju faleminderit!", tha Edmond Pjetraj.*

G.K/Shqiptarja.com

Share

G.K/M.G./Shqiptarja.com

TAG: Shqipëria Vrasje Konflikt per pronen Nazif Musai qytetet i njohur Haziz Musai Edmond Pjetraj Krim

Komentoni

Komente

Irie 07/09/2024 01:30
/OMORT/ Ja thua se gjithe fajl eshte i Evacipat i dhisi frutin e ndaluar /Adamit/ por ne te vertete isha /Adami/ ai qe na fundi vendosi vete te kafshoje frutin/kur mund te kishte theme /Ucit/ Mos hipocs grate pse burrat jane aq budallenj sa vrasin dhe njeri-tjetrin per nje dreieway!

Përgjigju

Qwert 06/03/2024 13:43
I fulen grat ne sherr nuk ka njeri ne bot mos te dij vlasin. i bej thirrje popullit mos ti degjojn gra, vetem ne krevat ti degjojn . edhe dhi sa me shum...

Përgjigju

Prona prona prona: 06/03/2024 12:44
Mos a ngopashë me pronat ,ka cfar prone mone me vehte ne vac, vetëm vdekje me lenet!

Përgjigju

Mert 06/03/2024 11:51
Kush na e ka fajin ??!vëllezër të mosshuar vrisen për një copë tokë!jam dhe fëmijët e nipërt e mbesat jan në hasmitë me njëri-tjetrin,fëmijët vrasin pronë!dhe ansapëllaq,komshijët vrisen me njëri-tjetrin,si mund të jetohet në këtë vënd ku,ta gëlbë jan ne hasmitë me njëri-tjetrin ?

Përgjigju

Ndalohet riprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016.

SH

Sondazhi i ditës:
Kë po dëmton kaosi në Kuvend?

Qeveritë | Opozitën | Opinionin

Lajme të tjera

Rezervuari i Kurjanit në Roskovec po thahet, nivelli i ujit në pikën kritike, 5 mijë hektarë tokë pa vaditje

Kristaq Thano

8 Mars, 17:49

Grupi italian 'Le rivoltelle' koncert për vajzat e grafë e Fierit: Synojmë të përçojmë mesazhe për autonomisë e lirinë e tyre

Kristaq Thano

8 Mars, 17:25

Lushnjë/ 'Benzi' përplaset me automjetin e tonazhit të rëndë, transportohen në spital 13-vjeçari dhe e ëma (VIDEO)

7 Mars, 19:45

Shpërthimi në Lushnjë ku vdiqën babë e bir, 3 akuza për deputetin Bujar Çela, dosja drejt SPAK/ Pezullohen nga detyra 5 punonjës të bashkisë dhe IMT-së (EMRAT)

7 Mars, 16:47

Shpërthimi te kapanoni në Lushnjë, burg për sipërmarrësin Leonard Gjini, i autorizuar nga Bujar Çela për ndërtim kapanoni

7 Mars, 16:03

Fier/ Në ambiente publike me pistoleta Glock, tre të arrestuar me urdhër të Prokurorisë

7 Mars, 12:33

Rama në Lushnjë: Të garantojmë një shumicë qeveriatëse të qëndrueshme, të arrijmë objektivat strategjikë të vizionit të Shqipërisë 2030

6 Mars, 20:20

VIDEO/ Hap dyert në prag të 7-Marsit shkolla 'Skënder Libohova' në Lushnje, Rama bën kosh në fushën e basketbollit

6 Mars, 17:10

Fier/ Lumi Gjanica ndotet sërish nga derdhja e naftës bruto (VIDEO)

3 Mars, 13:30

VIDEO/ Kishin përshtatur lokalin për lojëra fati, arrestohet menaxheri, në kërkim pronari

3 Mars, 11:49

Shpërthimi në Lushnjë, arrestohet sipërmarrësi i punimeve/ Sekuestrohen dokumentet e bashkisë! Prifet marrja në pyetje e deputetit PS-së, Çela

3 Mars, 10:57

Plagosja e 26-vjeçarit pas një sherri në Pogradec, lihen në burg 2 autorët

3 Mars, 10:50

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pawaturizuar i kesaj faqeje